



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGETIKES
DREJTORIA E SHERBIMEVE JURIDIKE

U R D H E R

Nr. 196, Date 09.03.2009

“PER MIRATIMIN E TIPIT TE INSTRUMENTEVE MATESE LIGJERISHT TE KONTROLLUARA”

Ne zbatim te nenit 22, pika 4, te Ligjit Nr.9875, date 14.02.2008, “Për metrologjinë”, me propozim te Drejtorisë te Përgjithshme te Metrologjisë, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes:

URDHERON:

1. Çdo instrument matës ligjërish i kontrolluar, qe prodhohet apo hyn ne Republikën e Shqipërisë, te miratohet (ose njihet) nga DPM. Miratimi i tipit te instrumenteve matëse ligjërish te kontrolluara, jepet nga Drejtori i Drejtorisë te Përgjithshme te Metrologjisë, ne përputhje me procedurën e paraqitur ne këtë rregullore, bashkëlidhur këtij Urdhri dhe ne baze te kërkesave te paraqitura ne Rregulloren e Këshillit te Ministrave “Për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse ligjërish te kontrolluara”, miratuar me Vendimin e Këshillit te Ministrave nr.1351, date 03.10.2008.
2. Ky urdhër është i vlefshëm deri ne momentin qe Shqipëria behet anëtare me te drejta te plota e Bashkimit Evropian.
3. Ky urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTRI

GENC RULI